

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve

Sot, pasi një në çdo tetë migrantë është një fëmijë dhe katër në dhjetë persona të zhvendosur me forcë janë fëmijë, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Rrjeti i Migrimit i Kombeve të Bashkuara në Kosovë rithekson domosdoshmërinë për rritjen e mbrojtjes dhe ofrimin e ndihmës për fëmijët në lëvizje.

Miliona fëmijë janë në lëvizje, si brenda dhe midis vendeve dhe rajoneve, me ose pa prindërit e tyre. Kushtet në të cilat zhvillohet lëvizja janë shpesh të rrezikshme, duke i vendosur fëmijët në lëvizje, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, në një rrezik të lartë të shfrytëzimit ekonomik ose seksual, abuzimit, neglizhencës dhe dhunës.

Kjo ditë na kujton të gjitha detyrimet tona ndaj fëmijëve, përfshirë migrantët dhe refugjatët, për të siguruar kushtet që do t'i mundësojnë ata të përparojnë. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve refugjatë dhe migrantë mbetet një sfidë e vazhdueshme dhe një angazhim afatgjatë. Globalisht, puna e Rrjetit të Migrimit të KB-së është rritur ndjeshëm në lidhje me sigurimin e ndihmës për fëmijët në lëvizje, veçanërisht atyre që janë të pashoqëruar, por shumë më tepër nevojitet. Fëmijët në lëvizje shpresojnë për një të ardhme më të ndritur. Është përgjegjësia jonë kolektive të krijojmë një botë më të qëndrueshme dhe më të sigurt për të gjithë, duke mos lënë askënd pas.

Rrjeti i Migrimit i KB në Kosovë, në bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë të angazhuar në mbështetjen e fëmijëve migrantë në Kosovë si dhe parandalimin në mënyrë proaktive të migrimin të parregullt të fëmijëve, veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar në komunitetet në rrezik.